



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.130/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alternativa, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Për Ardhmërinë E Kosovës (AAK), për shkak të përdorimi i pasurisë publike dhe shfrytëzimi i pozitës publike me qëllim të përfitimit të votave, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.130/2025, e datës 07.10.2025, parashtruar nga subjektit politik Alternativa, me seli në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Gjakovë, për shkak të përdorimit të pasurisë publike dhe shfrytëzimi i pozitës publike me qëllim të përfitimit të votave, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 07.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Alternativa, me seli në Gjakovë, në të cilën theksohet më datë 07.10.2025 në faqen zyrtare të Facebook-ut të Komunës së Gjakovës kamë parë video promovuese me logo të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Bashkë me formularin keni të bashkangjitur edhe CD me videon e postuar të Komunës së Gjakovës me logo të AKK-së.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), datë 08.10.2025, theksohet se në ankesën e parashtruar nga ana e subjektit politik "Alternativa", në asnjë pjesë të saj nuk është specifikuar data e publikimit të videos së pretenduar. Për pasojë,

në mungesë të një prove që përcakton kohën e saktë të kryerjes së shkeljes së pretenduar, ankuesja nuk ka mundur të dëshmojë se ankesa e saj është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar. Më tej, subjekti politik "AAK", thekson se kjo bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 39, par, 3 të Ligjit Nr. 08/L 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në mungesë të përcaktimit të saktë të kohës kur është kryer shkelja e pretenduar, nuk është e mundur të vërtetohet nëse ankesa është paraqitur brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orësh të paraparë me dispozitën e lartcekur, dhe si e tillë, nuk mund të konsiderohet se është e afatshme, pasi që barrën e provës për të vërtetuar se ankesa është e afatshme i takon ankueses. Për më tepër, në rastin konkret është e qartë se nuk ekziston asnjë element i ndonjë shkeljeje të dispozitave të LZP-së e apo të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Videoja në fjalë nuk përmban mesazhe politike, as thirrje për votim, dhe nuk është e karakterit promovues, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet material zgjedhor në kuptim të dispozitave ligjore. Po ashtu, ankuesja nuk ka mundur të argumentoj se ka pasur as përdorim të pozitës publike apo resurseve institucionale në kundërshtim me nenin 36 të LZP-së. Andaj, në mungesë të bazueshmërisë juridike dhe arsyeshmërisë së ankesës, i propozojmë PZAP, që të merr vendimin përmes së cilit ankesën ta refuzojë si të pa bazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Aleanca për ardhmërinë e Kosovës (AAK), vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Alternativa, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka mundur të provohen, respektivisht nuk është arritur të provohet koha e sakte e shkeljes së pretenduar, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Bazuar në këtë subjekti politik Alternativa, përmes videos të bashkangjitur nuk ka provuar kohën e kryerjes së shkeljes së supozuar. Në mungesë të një prove që përcakton kohën e saktë të kryerjes së shkeljes së pretenduar paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje ligjore - juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar

Si rrjedhojë nuk mund të verifikohet përmbushja e afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Andaj, në mungesë të provave paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje ligjore - juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.130/2025 më datë 10.10.2025

Kryesuesi e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.